


Après l'école, on fait quoi ?

Une campagne de la Ville de Lausanne
sur la transition école-métier.



PYETJE TË SHPESHTA PËR PRINDËRIT

ÇFARË ËSHTË NJË PROJEKT PROFESIONAL ?

Një projekt profesional është një plan afatgjatë për ndërtimin e një karriere. Ai përbëhet nga disa hapa, në të cilët nxënësi mëson të identifikojë interesat e veta, të ndërtojë rrjetin e kontakteve dhe të zhvillojë aftësi personale dhe profesionale.

SI MUND TA MBËSHOTES FËMIJËN TIM NË KËTË PROJEKT PROFESIONAL ?

Mbështetja nga një i rritur i besueshëm mund të jetë shumë e rëndësishme në fazat e ndryshme të projektit profesional të nëi fëmije. Kjo mbështetje mund të shprehet përmes bisedave rreth aftësive të fëmijës, dëgjimin të nevojave të tij/saj, ose ndihmës për ta kuptuar më mirë se cili është rrjeti i tij/saj.

CILI ËSHTË DALLIMI MES STUDIMEVE PROFESIONALE DHE ATYRE AKADEMIKE?

Të dyja rrugët ofrojnë mundësi të mira profesionale, por ndryshojnë në qasjet dhe qëllimet e tyre të ndryshme. Studimet profesionale fokusohen në aftësitë praktike dhe teknike dhe përgatisin nxënësin për tregun e punës. Studimet akademike, si p.sh. gjimnazi, përgatisin për universitetet dhe theksojnë njohuritë teorike.

KUSH MUND TË NDIHMOJË FËMIJËN TIM NË NDËRTIMIN E KËTIJ PROJEKTI?

Çdo person përreth tij/saj: familja, shkolla, miqtë, të njohurit në botën profesionale. Me falë të tjera: rrjeti i tij/saj.

SI MUND TË NDIHMOJË RRJETI?

Rrjeti është i rëndësishëm në çdo fazë të projektit. Ai mund të ndihmojë për të zhvilluar aftësitë personale ose për ta lidhur fëmijën tuaj me persona që mund t'i ofrojnë një praktikë.

ÇFARË RRUGE STUDIMI EKZISTOJNË PAS SHKOLLËS SË DETYRUESHME ?

Ka disa mundësi që ofrojnë një diplomë zyrtare dhe mundësojnë hyrjen në botën profesionale:

- Praktikë profesionale (CFC ose AFP)
- Gjimnaz (me maturë të përgjithshme ose shkollë të kulturës së përgjithshme)
- Maturë profesionale (CFC + maturë)
- Shkollë tregtare
- Shkollë e zanateve (ETML)

Në disa raste, ekzistojnë masa kalimtare si Shkolla e Tranzicionit (EdT) ose Semestri i Motivimit (SeMo), të cilat u japin nxënësve kohë shtesë për t'u përgatitur për projektin e tyre profesional, ndërkohë që vazhdojnë shkollimin. Megjithatë, këto nuk ofrojnë diplomë zyrtare.

SI MUND TË JETË E RËNDËSISHME NJË PRAKTIKË PËR FËMIJËN TIM?

- E ndihmon të përcaktojë ose të saktësojë projektin e tij/saj profesional
- Zbulon dhe zhvillon aftësi personale dhe profesionale
- E mëson të identifikojë mjediset e punës që i përshtaten atij/saj më shumë
- Shton përvojë në CV
- Forcon vetëbesimin dhe pavarësinë

ÇFAR DUHET BËRË NËSE FËMIJA IM NUK KA ASNJË IDE?

Përfundimi i shkollës së detyrueshme mund të jetë një periudhë e ngarkuar dhe stresuese për nxënësit. Prandaj, është normale që ata/ato të ndihen të pasigurt dhe të hutuar në këtë fazë të rrugëtimit të tyre. Eksperimentimi dhe eksplorimi përmes praktikave ose rrjetit mund të ndihmojnë për të gjetur drejtimin e duhur. Kjo mund të bëhet, për shembull, përmes një praktikë ose kërkimit të një vendi për mësim të aftësive profesionale. Pasi të jenë integruar në botën e punës, gjithmonë ekziston mundësia për të ndryshuar drejtimin profesional më vonë.



Për më shumë informacion
www.lausanne.ch/apres-ecole